

URDHËR
Nr. 155, datë 29.8.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”; të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor Sekretarit të Përgjithshëm, për të gjitha procedurat e prokurimit publik, koncesionet dhe partneritetin publik privat, për Ministrinë e Brendshme.
2. Kompetencat e deleguara të titullarit të autoritetit kontraktor të Ministrisë së Brendshme, në zbatim të dispozitave ligjore për prokurimin publik, do të ushtrohen për një periudhë të pacaktuar nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në shfuqizimin e tij.
3. Çdo urdhër i mëparshëm delegimi, që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha